

Këtë vit Kosova e pavarur, thonë Ruecker dhe Kather

Prizren, 16 prill - "Kosova këtë vit do të bëhet e pavarur dhe kjo falë vullnetit të popullit të saj, por edhe angazhimit të faktorit ndërkombëtar, si dhe po ndërtohet shoqëria demokratike", kështu kanë thënë të hënën shefi i UNMIK-ut, Joachim Ruecker dhe komandanti i KFOR-it, Gjenerali Roland Kather, gjatë një ceremonie në Prizren, ku është bërë përfundimi i projektit të gjimnazit "Loyaola", i cili është gjimnazi i parë privat në Kosovë.

Ata, duke vlerësuar se Kosova ndodhet para vendimit përfundimtar, kanë thënë se Kosova është një shoqëri demokratike dhe është në rrugë të mirë drejt ardhmërisë së saj.

Komandanti i trupave paqeruajtëse të KFOR-it në Kosovë, gjenerali Roland Kather, ka thënë se Kosova ka popullatën më të re në Evropë dhe kjo përbën optimizëm të madh për të ardhmen e saj.

"Dëshiroj që nga ky gjimnaz të dalë një sinjal i përbashkët për të gjithë, pa dallim etnie apo gjinie, pasi kultura dhe arsimit janë kryesoret për një shoqëri, ndërsa KFOR-i do t'i ndihmojë të gjitha shkollat që të ecin përpara", ka thënë ai.

Autoritetet më të larta vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, sikurse edhe ato të shkol-



lës, i kanë vlerësuar si të dukshme rezultatet e arritura brenda një kohe të shkurtër në gjimnazin "Loyola", të parin privat në Prizren. Bashkë me përfaqësues fetarë nga Vatikani, ata morën pjesë në ceremoninë e mbajtur me rastin e përfundimit të projektit në Kompleksin shkollor "Asociation Loyola-Gymnasium" (ALG).

Nënkryetari i komunës së Prizrenit, Ercan Spat, ka thënë se komuna ka pasur kënaqësinë ta ndihmojë këtë institucion shkollor, që për një kohë të shkurtër ka shënuar rezultate konkrete dhe se shumë shpejt pritet të dalin gjenarata të përgatitura, të cilat do ta ndihmojnë këtë vend.

Përfaqësuesi i shkollës, Ualter Happel, ka thënë se brenda një kohe të shkurtër, në këtë vatrë diturie janë shënuar rezultate të dukshme, ndërsa kjo është një dhuratë për familjet e këtushme, në mënyrë që fëmijët e tyre të shkollohen sipas standardeve evropiane.

"Duam të bëjmë diç për fëmijët e Kosovës, në mënyrë që t'i përmirësojmë shanset e tyre për integrim në një Evropë, e cila çdo ditë e më tepër po bashkohet. Për këtë, shkollimin nuk duhet kuptuar vetëm si dhënie e mësimit, por si parakusht qenësor për përfshirje në rrjedhat bashkëkohore", ka thënë ai.